





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality Viti/na

Në bazë të nenit 12, paragrafi 12.1 dhe paragrafi 12.2, shkronja d, neni 14, 17 paragrafi 1, shkronja p, neni 40 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës), neni 36, shkronja d të Statutit të Komunës së Vitisë Nr.01-013/491, të datës 21.04.2011, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të kryetarit të komunës me Nr. të Protokollit 07-035/02-191, të datës 25.02.2022, Kuvendi i Komunës së Vitisë, në mbledhjen e mbajtur më datën 28.02.2022, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e lokacionit për vendosjen e Bustit të Martirit Milaim Tahiri në fshati Gërmovë

Neni 1

Me këtë, Kuvendi i Komunës së Vitisë miraton vendimin për caktimin e lokacioni për vendosjen e bustit të martirit të kombit, Milaim Tahiri në fshatin Gërmovë, Komuna e Vitisë.

Neni 2

Lokacionin nga neni 1 i këtij vendimi caktohet në fshatin Gërmovë, i cili gjindet në Planin Zhvillimor Komunal Nr.01-013/126, e që përfshin sipërfaqen prej 230 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 8101m² të parcelës kadastrale me Nr.P-70101014-01217-0, në Zonën Kadastrale në Gërmovë, vendi i quajtur "Selo Cellapek", që evidentohet në pronësi të PSH RRUGËT në Gërmovë, Komuna e Vitisë.

Neni 3

Pjese përbërëse të këtij vendimi është fleta poseduese dhe kopja e planit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen: kryetari i Komunës së Vitisë, Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi dhe drejtoritë tjera të Komunës së Vitisë.

Neni 6

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-40 (Gazeta Zyrtare e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr.28/2008), neni 8 lidhur me neni 9 të Rregullores Nr.10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të komunave dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Vitisë.

Vendimi u dorëzohet:

1. Zyrës së Kryetarit;
2. Drejtorisë për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi;
3. MAPL-së; dhe
3. Arkivit.

KUVENDI I KOMUNËS SË VITISË
K R Y E S U E S I
Bekim Azizi





Në bazë të nenit 58 paragrafi 1 pika h të Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale nr. 03/L-40 të Kuvendit të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare nr.28/2008), neni 50 paragrafi 1 shkronja I, të Statutit të Komunës së Vitisë 01 nr.013/491 të datës 21.04.2011 dhe kërkesa e Këshillit të fshatit Germovë me nr.01-070/01-81, e datës 26.01.2022, Drejtoria për Kadaster, Pronë dhe Gjeodezi me datën 24.02.2022 bën këtë vendim.

07-035/02-191
24.02.2022

PROPOZIM VENDIM PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E BUSTIT TË MARTIRI MILAIM TAHIRI NË FSHATIN GËRMOVË

Neni 1.

Me këtë propozim – vendim , propozohet të caktohet lokacioni për vendosjen e bustit të martirit të kombit Milaim Tahirinë fshatin Germovë, komuna e Vitisë.

Neni 2.

Lokacionin nga pika neni 1 i këtij propozim vendimi caktohet në fshatin Germovë, i cili gjindet në planin zhvillimor komunal nr.01-013/126 , e që përfshin sipërfaqen prej 230 m² nga sipërfaqja e përgjithshme prej 8101m², të parcelës kadastrale me nr. P-70101014-01217-0, në zonën kadastrale në Germovë , vendi i quajtur „ Selo Çellapek“, që evidentohet në pronësi të P.SH RRUGËT në Germovë, komuna e Vitisë.

Neni 3.

Pjesë përbërse të këtij propozim –vendimi është : fleta poseduese , kopja planit.

Neni 4

Për zbatimin e këtij propozim-vendimi do të kujdesen: Kryetari i Komunës së Vitisë , Drejtoria për Rini , Kultur dhe Sport dhe drejtorit tjera të komunës së Vitisë , do të kryejn veprimet e tyre nga përgjegjësit e tyre të caktuara për relaizimin e këtij propozim vendimi.

Neni 5.

Ky Propozim-Vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së dhe publikimit në gjuhët zyrtare në uebfaqen e Komunës.

Drejtori:
Majlinda Ostroglava



Kryetari i Komunës:
Sokol Haliti





Republika e Kosovës

Republika Kosova

Republik of Kosovo

REPUBLICA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISE - OPSTINA VITINA

Numeri i Vitesit: 11-02-2022

Numri i Dokumentit	Numri i Vitesit	Numri i Dokumentit	Numri i Vitesit
01-070/01-81			



Komuna e Vitisë

Opstina Vitina

Municipal Vitina

Për	z. Bekim Azizi - Kryesuesin e Kuvendit të Komunës së Vitisë.
Nga	Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit – Sektori i Planifikimit. Viti
Lënda	Caktimi i lokacionit për ndërtim të parkut ,bustit të martirit Milaim Tahiri ne Gërmovë.

Ne baze të kërkesës nr.01-070/01-81 të datës 24.01.2022 nga Kryesuesi Kuvendit Komunal në Viti e cila kërkon nga drejtoria e Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit përkatësisht nga sektori i planifikimit hapësinorë, të gjej hapësirën e planifikuar për ndërtimin e parkut, bustit të martirit Milaim Tahiri në Gërmovë në parcelën nr.1217-0 z. k **Germovë**.

Pas shqyrtimit në ju udhëzojmë se parcela 1217-0 me sipërfaqe 8101 m² z. k. Germovë është brenda kufijve të ndërtimit sipas planit zhvillimor komunal nr.01-013/126 dhe është në pronësi pasuri shoqërore-rrugë që duhet të ndahet në një sipërfaqe ndërtimore rreth **S=230m²** duke respektuar gjendjen ekzistuese të qasjeve në rrugët lokale të shtëpive në atë zonë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor/Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja/Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale/Opštinska katastarska kancelarija: Viti

Nr. i njësisë kadastrale/Br. katastarske jedinice : 1217-0

Zona kadastrale/Katastarska zona: Gërmovë

Numri i lëndës/Broj predmeta: _____


Lloji i njësisë kadastrale Vrsti katastarske jedinice : Parcelë

Shkalla e zvoglimit/Razmera plana 1: 500

PROPOZIM NDARJE



Nr.	Y	X
1	7525992.419	4686634.02
2	7526010.41	4686631.307
3	7526010.293	4686637.375
4	7526004.025	4686651.039
5	7525993.818	4686643.349



Rilevoi Snimio: Feat SHAQIRI
(emri dhe mbiemri i geodetit kompanisë tme i prezime geodeta kompanije)


Aprovoi/Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar tme i prezime shërbenog lica)

Nr. i licencës/Br. licence: _____

V.V.

Nënshkrimi Potpis: _____

Nënshkrimi Potpis: _____



Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis
Sektori i Planifikimit ne baze te kërkesës:
nr.01-070/01-81 te datës 24.01.2022

Hapësira e Planifikuar për ndërtim

Kordinatat:

Pika 1.	7525992.419	4686634.020
Pika 2.	7526010.410	4686631.307
Pika 3.	7526010.293	4686637.375
Pika 4.	7526004.025	4686651.039
Pika 5.	7525993.818	4686643.349

Pas ndarjes duhet te aplikohet për Caktimin e kushteve te ndërtimit sipas nenit 21 te Ligjit NR.04/L-174 Për Planifikim Hapësinorë.

Viti

08.02.2022

Ing.i dipl.i ark.Xhevdet Halili

Përgjegjës për Planifikim:

Ida.Xhevdet Halili

Drejtori:

Visar Demiri



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedetit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës / Ministarstvo Životte Sredine, Prostorinog Planiranja i Infrastrukture /
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVES / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVO CADASTRAL AGENCY

CERTIFIKATË / CERTIFIKAT / CERTIFICATE

NJËSIA KADASTRALE / KATASTARSKA JEDINICA / CADASTRAL UNIT : P-70101014-01217-0

Numri i lëndës / Broj Predmet / Case Referent Number:

Data dhe koha e lëshimit / Datum i vreme izdavanja / Date and time of submission:

Komuna / Opština / Municipality:

Zona kadastrale / Katastarska Zona / Cadastral Zone:

Zyra Kadastrale Komunale / Opštinska Katastarska Kancelarija / Municipal Cadastral Office: VITI / VITTINA / VITI

214/2022

23.02.2022 - 15:33

VITI / VITTINA / VITI


Germovë / Grmovo / Germovë

A. TË DHËNAT PËR NJËSINË KADASTRALE / PODACI O KATASTARSKOJ JEDINICI / CADASTRAL UNIT DATA

Numri i njësisë kadastrale Broj katastarske jedinice Cad. Unit. No.	Lloji i njësisë Vrsta jedinice Unit Type	Lloji i pronës Vrsta inovine Property Type	Zona U/R G/S U/R	Sipërfaqja Površina Area (m ²)	Pershkrim Opis Description	Krijuar më datën Uradjeno na dan Created On	Azhuruar Ažurirano Updated
P-70101014-01217-0	PARCELË / PARCELA / PARCEL	Pronë shoqërore / Društvena Inovina / Socially owned Land		8101			


A.1 ADRESA E NJËSISË KADASTRALE / ADRESA KATASTARSKE JEDINICE / CADASTRAL UNIT ADDRESS

Vendbanimi - adresa Prebivalište - adresa Resident - address	Kodi Postal Poštanski kod Postal Code	Hollësitë e adresës Pojednostni adrese Address Details
SELO ÇELOPEK POLJSKI PUT/SELO ÇELOPEK POLJSKI PUT/SELO ÇELOPEK POLJSKI PUT		



A2 LLOJJI I SHFRYTËZIMIT / VRSTA KORISCENJA / TYPE OF USE

Numri Broj Number	Lloji i shfrytëzimit të parcelës Vrsta koriscenja a parcele Parcel Type Of Use	Shfrytëzimi aktual i parcelës Trenuto koriscenje parcele Parcel Current Use	Kualiteti i klasës Kvaliteti klase Quality Class	Sipërfaqja Površina Area
1	Infrastruktura/Infrastruktura/Infrastructure	Rrugë E Pakegjeve/Nekategorisani Put/UncategorizedRoad		8101




B. PRONARRI/POSEDUESI - VLASNIK/DRŽALAC - OWNER/POSSESSOR

Të drejtat Prava Rights	Emri Ime Name	Nr. personal Licen broj ID. No.	Vendbanimi Prebivaliste Resident	Kodi postal Poštanski kod Postal code	Hollësitë e adresës Pojednosti adrese Address details	Pjesa e pronës Deo imovine Share quota	Pershkrimi Opis Description	Azhuruar Ažurirano Updated
Posedim individual / Individualna Drzavina / Single possessor	P.SH.RRUGËT	KCID1211070	VINARCI POSHTËM / DONJE VINARCE / VINARCI POSHTËM /			1/1		



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

DATE/A	04.06.2021
REFERENCË	
NGA (OD) FROM	z. Naim PIRA –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
CC:	
PËRMES(PREKO)THROUGH	Drejtperdrejtë
PËR (ZA) TO	znj. Majlinda Ostrogllava, Drejtoresh e Katastrit..... z. Ajet Sallahu, Drejtor për urbanizëm, planifikim dhe mbrojtje të mjedisit
TEMA (SUBJEKAT) SUBJECT	Cedim i kërkesës

Me datë: **03.06.2021**, kemi pranuar një kërkesë nga z. Vebi Tahiri Administrator i fshatit Gërmovë, i cili kërkon nga Kuvendi i Komunës së Vitisë që të ju mundësohet ndërtimi i bustit në parcela me Nr. 1217, ndërtimin i bustit të martirit Milaim Tahiri në qendrën e fsh.Gërmovë, Meqenëse Kuvendi nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë, ua dërgojmë drejtorive përgjegjëse për shqyrtimin e çështjes në fjalë dhe ndërmarrjen e hapave të mëtuftjeshëm.

Të bashkangjitur, keni kërkesën me nr. 01-320/04-19727 e datës: 03.06.2021

I dërgohet:

1. Drejtorisë së Kadastër, Prone, Gjeodezi
2. Drejtor për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
3. z. Vebi Tahiri Administrator i fshatit Gërmovë
4. Sekretarisë së Kuvendit Komunal

Viti, 04.03.2021



KËRKESË

KUVENDI I KOMUNES

REPUBLIKA E KOSOVës
KOMUNA E VITIT

03-06-2021

01-320/04-19727

Për: Kuvendin komunal në Viti.

Këshilli I fshatit Gërmovë në takimin e mbajtur më datën 13.05.2021.

Është marrë vendim për ndërtimin e bustit të martirit Milaim Tahiri në qendrën e fshatit Gërmovë duke ju përmbajtur të drejtave ligjore .

Në vëndin në qendër të fshatit tek ura, Parcellën nr:1217 . përmendim se parcella e propozuar nuk është pengës për qytetarët, andaj kerkojm nga tituli I lartepmendur qe te na mundesoi ndertimin e bustit.

Mbetemi me shpres se kjo kerkes do te na aprovohet.

Kërkesa I dërgohet : Kuvendit Komunal në Viti.
Kryetarit. Naim Piraj

Gërmovë Më :13.05.2021

Këshilli I Fshatit: Administratori I fshatit:

Vebi Tahiri. *Vebi Tahiri*

Nr. 1013211830

- | | |
|----------------------|----------------------|
| 1. Veli Tahiri | Turs |
| 2. Blaim Lamallari | Blaim |
| 3. Isuf Bajrami | Isuf |
| 4. Isvit Ismajli | Ismajli |
| 5. Snedov Sylejmani | |
| 6. Lardana Sylejmani | Lardana |
| 7. Mejdi Fehani | Mejdi |
| 8. Bashkim Lamallari | Bashkim |
| 9. Fejzullah Memaj | Fejzullah |
| 10. Hesat Hasani | Hesat |
| 11. Edona Sylejmani | Edona
E-Sylejmani |



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E VITISË - OPSTINA VITINA



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Pranuar - Prilqenur / Accepted - Prilqenur / 24-01-2022			
Numri i Dokumentit / Document Number	Numri i Kërkesës / Request Number	Emri i Prilqës / Accepted Name	Vlera e Vlerësuar / Estimated Value
01-020	101-81		

Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

DATË/A	24.01.2022
REFERENCË	
NGA (OD) FROM	z. Bekim Azizi –Kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë
CC:	
PËRMES(PREKO)THROUGH	Drejtperdrejtë
PËR (ZA) TO	znj. Majlinda Ostrogllava, Drejtoresh e Katastrit..... z. Visar Demiri, Drejtor për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
TEMA (SUBJEKAT) SUBJECT	Cedim i kërkesës

Me datë: 24.01.2022, kemi pranuar një kërkesë nga z. Jashar Misini nga fsh. Gërmovë, i cili kërkon nga Kuvendi i Komunës së Vitisë ndarjen e hapësirës publike në zonën kadastrale në Gërmovë me Nr. Të parcelës: 1217, për rregullimin e parkut, sheshit dhe bustit të martirit të kombit Milaim Tahiri.

Meqenëse Kuvendi Komunal nuk është kompetent për shqyrtimin e kësaj kërkesë, ua dërgojmë Drejtorive përgjegjëse për shqyrtimin e çështjes në fjalë dhe ndërmarrjen e hapave të mëtujuar.

Të bashkangjitur, keni kërkesën me nr. 02-320/04-3278 e datës: 20.01.2022.

I dërgohet:

1. Drejtorisë së Kadastër, Prone, Gjeodezi
2. Drejtor për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit
3. z. Jashar Misini fsh. Gërmovë.
4. Sekretarisë së Kuvendit Komunal

Viti, 24.01.2022

Kryesuesi i Kuvendit
Bekim Azizi

Pranuar - Prilqevje Me/Dana 20-01-2022			
Nr. I organit Org. broj	Nurriti/ Broj	Shtetice Prilog	Vlera Vendoset
02-320/04-3278			

Drejtuar Kryetari të Komunes Z.Sokol Haliti dhe
Kuvendit Komunal të Vitis

Kërkesë

Lënda:

Kërkes për ndjarje të Hapsires publike në zone kadastrale në Gërmovë me nr të parceles: 1217 për rregullimin parkut, sheshit dhe bustit të martirit të kombit Milaim Tahiti, i kindabuar, turturuar e masakruar dhe vrat në daten: 12.02.1992 nga forcat okopuse ushtarake e paramilitare gjenocidale Serbe.

Martiret e kombit jan gure themel të Shtetit të Kosoves, në temelin e Shtetit është edhe martiri nga F,sh Gërmovë Milaimi Tahiri, prandaj kërkojm nga ju që kerkesa jom të has në mire kuptim.

Ju faleminderit sinqerisht kshilli inicues nga Fshati Germovë, familja Tahiri.

Me Daten:

20/01/2022 Gërmovë - Viti

Ushtguesi I Kerkeses:

Jashar Misini Nrp: 1030456986



